



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 par 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 13 të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë si dhe nenit 20 par. 20.1 dhe 36 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e datës 31.01.2022, të miratojë këtë:

V E N D I M PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 1 Themelimi

Me këtë Vendim, **Themelohet** Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Rinor Murati, anëtar nga subjekti politik LDK
2. Fadil Sopa, anëtar nga subjekti politik LDK
3. Shkelzim Olluri, anëtar nga subjekti politik LDK
4. Ardit Cani, anëtar nga subjekti politik PDK
5. Bashkim Budakova, anëtar anëtar nga subjekti politik AAK

Neni 2 Zgjedhja e Kryesuesit

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtar i më i vjetër i komitetit.

Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për kulturë rini dhe sport kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

1. Bën monitorimin e aktiviteteve të ndryshme në nivel të komunës nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit.
2. Konsultohet dhe ndihmon Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit.
3. Kryen dhe punë të tjera nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit.

Neni 4
Mandati

Komiteti për kulturë, rini dhe sport ka mandat 4 vjeçar

Neni 5
Kompensimi

- Anëtarët e komitetit për kulturë, rini dhe sport, kompensohen nga buxheti i komunës.
- Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përherëshme.
- Anëtarët e komiteteve tjera paguhen për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 020-6053

Lipjan, më 31.01. 2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

